

RAPORT I AUDITORES TE PAVARUR  
PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUAR DHE TE SHPENZUARA  
FUSHATA ZGJEDHORE 2015

---

**RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR PËR QËLLIME TË VEÇANTA  
PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA  
PARTIA LIGJ DHE DREJTESI**

Tirane më, 20 TETOR 2015

## **Tabela e përmbajtjes**

### **RAPORTI I VEÇANTË I AUDITIT TË PAVARUR PASQYRA E TË ARDHURAVE (Financimet dhe Donacionet) PASQYRA E SHPENZIMEVE (Përdorimi i fondeve sipas destinacionit) INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME**

#### **Referencat ligjore:**

Për kryerjen e këtij misioni jemi mbështetur në përputhje me:

- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit me referencë të veçantë SNA 800.
- Ligjin nr.10019.datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"
- Ligjin nr.10091.datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar"
- Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“
- Çdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë .

RAPORT I AUDITORES TE PAVARUR  
PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUAR DHE TE SHPENZUARA  
FUSHATA ZGJEDHORE 2015

---

***Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve***

Une kam audituar pasqyrën (deklaratën) bashkëlidhur të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partia Ligj dhe Drejtesi per fushaten zgjedhore 2015.

***Pasqyra eshte pergjegjesi e drejtimit te subjektit zgjedhor*** Partia Ligj dhe Drejtesi.

Kjo pasqyrë (deklarata) është përgatitur nga Partia Ligj dhe Drejtesi bazuar në librin e llogarive të Partisë dhe të rregjistrin të posaçëm, miratuar si model me vendimin e KQZ-së, të cilët janë mbajtur për të pasqyruar të gjitha transaksionet në lidhje me fushatën zgjedhore , që kanë dhënë bazën për përgatitjen e pasqyrës së arkëtim – pagesave.

***Përgjegjësia ime*** është të shpreh një opinion mbi këtë pasqyrë bazaur në auditimin tim.

Unë kam kryer auditimin në përputhje me Standartet Kombetare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që unë të veprojmë në pajtim me kërkesat e etikës dhe të planifikojmë të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për faktin që pasqyrat financiare të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore te vitit 2015 të mos përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumatat dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve , audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të Partisë në lidhje me prëgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare , me qëllim që ai të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të nevojshme për rrethanat financiare, por jo me qëllimin që të shprehë një opinionin për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të partisë.

Auditimi përfshin gjithashtu shqyrtimin mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumatat dhe deklarimet në pasqyrat financiare, vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi i Partia Ligj dhe Drejtesi, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që unë kam siguruar është e mjaftushme dhe e përshtateshme për të dhënë një bazë opinionin tim të auditimit.

Detyra e subjektit zgjedhor Partia Ligj dhe Drejtesi është të përgatisë pasqyrën bashkëlidhur mbi bazën e arkëtimeve dhe pagesave.

Për mendimin tim, pasqyra e bashkëlidhur e fondeve të përfituar dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partia Ligj dhe Drejtesi e datës 15.10.2015, është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën arkëtimeve dhe pagesave konform me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 I ndryshuar 'Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare'.

Silvana Gjikhima

Eksperte Kontabile e Rregjistruar

Tiranë , më 20. 10.2015

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR**

Subjekti zgjedhor Partia Ligj dhe Drejtësi

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr. 8580 datë 17.02.2000 "Për Partitë politike" neni 9, 10, 11 e të tjerë.

Partia për "Ligj dhe Drejtësi" është një Bashkim Politik i qytetarëve shqiptarë të cilët i bëjnë tok idealet e përbashkëta për Demokracinë Liberale, Laike, dhe Reformiste Europiane. Të gjitha aspiratat dhe veprimet e veta politike ata i mbështetin në vlerat universale të lirisë, drejtësisë, dhe solidaritetit njerëzor. Të gjithë bashkë nisen nga principi i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit dhe për ngritjen e një ekonomie moderne shqiptare mbështetur tek tregu i lirë dhe inisiativa private

Qendra e Partisë Partia Ligj dhe Drejtësi është në Tiranë.

Organet kombëtare të partisë për Ligj dhe Drejtësi janë:

1. Kuvendi Kombëtar.
2. Asambleja Kombëtare.
3. Kryesia.
4. Kryetari i partisë
5. Kryetari i Asamblesë Kombëtare.
6. Sekretariati

Burimet e financimit janë :

- Buxheti i Shtetit financiar për fushatë 391,524 leke.

-Kuotat e antaresise jane ( 0 ) lekë.

- Te ardhura ndihma nga anetaret e Partise 0 leke

Burimet financiare janë përdorur drejtpërdrejt për të realizuar qëllimet dhe objektivat e subjektit zgjedhor.

### **1. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL**

#### **a. Mënyra e Prëgatitjes së Pasqyrave Financiare.**

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar, të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare,“ të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhën vendase në Lekë .

#### **a. Rregullat për vlerësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.**

##### **Të Ardhurat.**

**Të ardhurat** janë të pasqyruara mbi bazën e arkëtimeve të burimeve të financimit të vëna në dispozicion të Partia Ligj dhe Drejtesi. Fondi 391,524 leke i dhene nga buxheti I shtetit nuk eshte terhequr nga KQZ –ja dhe nuk eshte arketuar ne bange.

**Detyrimet, ose Shpenzimet** janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave tatimore, mandat arktimëve dhe mandat pagesave dhe dokumentave orgjinale kontabël.

Shpenzimet sipas analizes jane te pasqyruara te pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve ne Shumen 353,064 leke.

Të gjitha shpenzimet janë te palikuiduara tek furnitoret . Me terheqjen e fondit do te kryhet dhe likuidimi I furnitoreve.

Detyrimi qe parashikon neni 90 , pika 2 i Kodit Zgjedhor nuk eshte permbushur nga Subjekti Zgjedhor . Nuk ka hapur llogari bankare prane nje banke te nivelit te dyte 30 dite para fillimit te fushates , siç parashikon Kodi zgjedhor.

Tiranë më, 20 TETOR 2015

**PARTIA LIGJ E DREJTESI  
PASQYRA E ARKËTIMEVE PAGESAVE TË BËRA  
PËR FUSHATËN ZGJEDHORE VITI 2015**

Përshkrimi	Lekë
<b>A- Të Ardhurat</b>	
Fondi financiar nga buxheti për fushatën zgjedhore	391,524
Total I te ardhurave nga kuota e antaresise	
Fonde të dhuruara nga persona fizik për fushatë	
<b>Fonde të përftuara nga keshilltaret</b>	
<b>Totali të ardhurave, burimeve, (arkëtimeve)</b>	<b>391,524</b>
<b>B- SHPENZIME PËR FUSHATËN</b>	
1- Shpenzime telefon dhe interneti	17,064
2- Marje sale me qera	336,000
<b>Total ii shpenzimeve</b>	<b>353,064</b>
<b>Teprica e burimeve neto</b>	<b>38,460</b>

KRYETARI I PARTISE LIGJ E DREJTESI  
SPARTAK NGJELA





